



PRANUAR MË:
ACCEPTED ON:
PRIMLJENO:

23/10/2024
02/422



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË

PROCESVERBAL

i mbledhjes së -II- (dytë) të rregullt të Kuvendit Komunal të Malishevës

Mbledhja u mbajt me datë:29.02.2024 dhe filloi në ora:10:25.

Në mbledhje morë pjesë: 24 asambleistë, Kryesuesi i Kuvendit Argjend Thaçi, Kryetari i Komunës Ekrem Kastrati, drejtori për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural Sylë Dukolli, drejtori për Urbanizëm Avdi Morina, drejtori për Inspektoriat Avdi Morina, drejtori për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë Bashkim Krasniqi, zyrtari ligjor i Kuvendit Muharrem Morina, dhe zyra për informim.

Kryesuesi Argjend Thaçi: Përshëndetje për të gjithë dhe mirë se keni ardhur!

Hapi mbledhjen e -II- (dytë) të rregullt të Kuvendit të Malishevës. Prezent në mbledhje jemi 24 antarë dhe mund të vazhdojmë me punimet e mbledhjes. Me leje mungon Labinot Gashi.

Para se të fillojmë me rend të ditës, a ka dikush për diskutim jashtë rendit të ditës?

Urdhëro, Amrush Helshani!

Amrush Helshani (anëtar nga Nisma Socialdemokrate): Dua të ngris shkurtimisht disa qështje të cilat bazohen në takime të ndryshme me përfaqësues relevant.

Qështja parë ka të bëjë me organizimin e seancave solemne nga ana e Kuvendit të Komunës, seanca pa asambleistë është shumë e mangët dhe mendoj që duhet të ceket dhe të trajtohet sepse në seancën e fundit të shënimit të përvjetorit të Pavarsis kanë qenë rreth 10 anëtarë të asambles. Po ashtu i nderuar

Kryetar, punëtorët e komunës e kanë pushim çdo festë zyrtare dhe po shoh shumë pak zyrtar të pranishëm, besoj që e kanë obligim të jenë prezent apo presin ftesë zyrtare.

Drejtori i Kulturës nuk është prezent, por si do që të jetë pytjen do të i'a përcjell. Kam takuar disa përfaqësues të organizatave rinore në Komunën e Malishevës, ku këto organizata janë grupime të cilat përfshijnë të rinjtë dhe të rejat të cilët janë të përqëndruara në ndërmarrjen e veprimtarive të ndryshme për t'i përmbushur qëllimet e tyre të përbashkëta. Roli i këtyre organizatave është shumë i ndjeshëm dhe shumë dimenzional në shoqëri, duke i ofruar një

platformë për angazhimin e të rinjëve në zhvillimin e tyre personal, shoqëror dhe profesional. Organizatat rinore përfaqësojnë interesat dhe shqetësimet e të rinjëve në nivel lokal, ata mundën të llobojnë për politikën të cilat ndikojnë në të drejtat dhe mirëqenien e të rinjëve. Këto organizata ofrojnë mundësi për të rinjë dhe për tu angazhuar në aktivitete sociale, kulturore dhe argëtuese, duke promovuar diversitetin dhe bashkëpunim ndërmjet individëve.

Pyetja ime është: Kur do të shpallet thirrja publike për subvencionim të organizatave jo qeveritare?

Sa organizata rinore funksionojnë dhe janë aktive në Malishevë?

E kemi një qendër rinore publike e cila për arsye të renovimeve është e mbyllur dhe aktivitetet e saj bëhen herë të shtëpia e kulturës dhe herë të biblioteka e qytetit. Një qendron dhe këshilli veprimtar rinor lokal. Kryetar, këto organizata kanë nevojë për përkrahjen tonë siç e kanë organizatat e sportit. Këto organizata janë përkrahur me nga 2.000.00E me thirrjen publike të fundit e që është shumë e vogël në krahasim me punën që duhet të bëhet.

Pyetje për Drejtorin e Urbanizmit, ju kam njoftuar dhe përmes Komitetit për Komunitete është një kërkesë nga Lagjia Osmanaj nga Kieva për vazhdim të kanalizimit rreth 250m dhe kërkoj që mbrenda mundësive të përfundohet sa më shpejt që është e mundur. Po ashtu në fshatin Senik, ndriqimi publik nuk funksionon që 2 muaj. Ky shqetësim është dhe nga përfaqësuesit e lagjes Halitaj të cilët me pëlqim të Komunës dhe me vetë financim i kanë vendosur 10 trupa të ndriqimit publik, por për arsye të prishjes së këti rrjeti ky ndriqim nuk funksionon.

Pyetjet e fundit për Drejtorin e Inspektoriatit. Kur do të fillojnë punimet në pjesën e dytë të rrugës Ibrahim Mazreku?

A janë vizituar bizneset?

A janë njoftuar bizneset në atë pjesë dhe si është disponimi i tyre?

Vitin e kaluar e keni parë që Komuna e Malishevës ka larguar shumë deponi ilegale, duke pastruar shumë hapsira publike në shumë fshatra. Është shumë e rëndësishme që qështja e deponive ilegale dhe hudhja e mbeturinave vend e pa vend të trajtohet në mënyrë efektive dhe në mënyrë të vazhdueshme për të ruajtur mjedisin dhe shëndetin publik. Kërkoj nga Inspektoriati dhe nga personat përgjegjës që të dalin në teren dhe të marrin masa për ata që po e bëjnë këtë dukuri jo të mirë. Faleminderit.

Kryesuesi Argjend Thaçi: Urdhëro, Halil Morina!

Halil Morina (anëtar nga Nisma Socialdemokrate): Unë dua të ngris një shqetësim serioz dhe një problematik shumë të madhe që janë duke u përballur qytetarët e fshatit Astrazup më shumë se sa një vit. Për një vit vetëm në lagjen Vataj janë thyer dhe janë plaqkitur më shumë se 6-7 shtëpi. Përveq dëmit financiar që shkaktohet së fundi besoj e keni parë në media, në mbledhje duke qenë familjarët në shtëpi hynë plaqkitësit dhe shkaktojnë vjedhje, por përveq dëmit financiar kjo shkakton një pasiguri të madhe. Si ka mundësi me u thy me një lagje 6-7 shtëpi dhe ende mos me u kap dorasit. Në rastin e fundit unë kam parë që kamerat kanë kapur njerëz, shihen figura të njerëzve pa maska në kamera, dëgjohen zëra dhe prapë organet e sigurisë nuk janë në gjendje me zbulu.

Unë e kam një shqetësim tjetër, organet e sigurisë janë duke u shëndrruar vetëm në institucionet

të gjobë dhënies, dalin në rrugë dhe të ndalin për tejkalim të shpejtësis për 5km në orë dhe duhet me ta dhënë një gjobë në rregull këtë punë e keni, por punë e keni dhe mem ndi mu me qenë i sigurtë në shtëpin time. Ne e kemi me diskutu këtu një raport të këshillit për siguri në bashkësi, por unë kisha kërkuar Kryetar nga ti me diskutu me Drejtorin e stacionit Policor në Malishevë me u përkushtu më shumë në këtë qështje.

Kryesuesi Argjend Thaçi: Urdhëro, Agnesë Kastrati!

Agnesë Kastrati (anëtare nga VV): Fillimisht dua me i uru mirëseardhje Kryetarit, prezenca e tij ka qenë shumë e nevojshme, sepse në seancat e fundit disa pyetje të cilat i kam drejtuar nuk kam marrë përgjigje nga Nënkryetari, sepse i ka pasur pyetjet e mia të pa qarta. Shpresoj që t'i Kryetar do të përgjigjesh në këto pyetje.

Ministria e Arsimit dhe planifikimit hapsinor dhe infrastrukturës ka hapur një thirrje për bashkfinancim të projekteve, do të doja të di nëse Komuna e Malishevës ka aplikuar për ndonjë projekt nëse po për cilin, nëse jo përse?

Si dhe pyetja tjetër që e kam ngritur së paku 4 seanca radhazi është që në fund të vitit ne e kemi votuar një mbështetje për strehimoren e viktimave të dhunës në familje në Gjakovë, ku strehohen dhe viktimat e dhunës nga Komuna e Malishevës. A është ekzekutuar ai vendim, a i kanë dalë strehimores mjetet financiare të cilat i ka votuar ky kuvend?

Kryesuesi Argjend Thaçi: Urdhëro, Eqrem Morina!

Eqrem Morina (anëtar nga AAK): Unë dua të i ngris disa qështje.

Qështjen e parë e ngriti dhe Halili për sigurinë e mbrendshme publike në Komunën e Malishevës, përkatësisht në fshatin Astrazup. Mund të themi se është e brishtë dhe shumë shqetësuese sepse janë shfaqur persona të panjohur dhe po i plaqkitin shtëpit. Rasti i fundit ka ndodhur me datën: 07.02.2024, persona të panjohur kanë hyrë në shtëpin e Shaip Morinës, ku kanë vjedhur një shumë të konsiderueshme të paras dhe stoli ari.

Për fat të keqë viktimë kam qenë dhe unë me datën: 02.08.2022 më është thyer shtëpia nga hajnat, dhe që nga ajo datë deri më tani nuk kam pranuar asnjë raport policor. Hajnat mbesin të lirë dhe nëse nuk identifikohen kjo është shumë shqetësuese. Këtë shqetësim po e paraqes në Kuvend, ku përmes Kuvendit të ndikojmë në këshillin Komunal për siguri në bashkësi, pasi që është organ këshillues për qështje të siguris të cilat në bashkëpunim me policin janë marrë me identifikimin e brengave lidhur me sigurin e mbrendshme publike.

Qështja tjetër ka të bëjë me objektin e ndërtuar te organizata e veteranëve të luftës te varrezat e dëshmorësve në Malishevë. Objekti në tërësi është i rregulluar por i mungon inventari, pra paraqesim kërkes që sa më parë të jetë në funksion.

Kryesuesi Argjend Thaçi: Urdhëro, Valon Krasniqi!

Valon Krasniqi (anëtarë nga Lista Guxo): Sa i përket jashtë rendit të ditës unë i kam disa qështje për t'i ngritur. Shqetësimi parë ka të bëjë me politizimin e përpikt dhe pothuajse 100% të shkollave në Komunën e Malishevës. Ku shihet që shkollat tona janë të kapura nga pushteti lokal dhe ato aksidentalisht ato menaxhohen nga militant të partive ose të themi ndryshe

menaxhohen nga njerëz me kredibilitet të jashtëzakonshëm por te qytetarët po shihen si tifoze partiak. Kjo dhemb shumë ku jemi të vetëdijshëm për presionin që mund ta kenë nga eksponent politik në Malishevë. Kërkoj që kjo qasje të ndërpritet dhe drejtorave të shkollave përpos që mos të ju bëhet presion politik, ata të kenë kohë të kuptojnë që është më mirë të mirren me përgjegjesit e tyre në shkolla se sa të përfshihen në tifozeri partiake.

Shqetësimi tjetër kërkoj që të gjendet një zgjidhje sa më shpejtë për qështjen e qenëve endacak. Një shqetësim që është ngritur disa herë dhe nga kolegët e Kuvendit dhe asnjëher nuk kemi marrë ndonjë rezultat. Para ca ditëve kam reaguar publikisht me një video për këtë qështje në rrjetet sociale, po ashtu dhe nga qytetarët të shumë që jetojnë në qytezën e Malishevës ata dyshojnë që qenët endacak persona të ndryshëm po i sjellin nga vendet e tjera në qytezë dhe ky fenomen duhet të ndalet menjëher. Unë po ashtu kam pasur një bised me një mik timin që është pjesë e Komunës së Vitis dhe sigurisht kemi shkëmbyer forma që dhe nëse ekziston momenti mund të bëhet zgjidhje pasi që ata kanë bërë një zgjidhje për qenët endacak. Edhe ne me ekspertët e kësaj fushe duhet të merremi urgjentisht me këtë shqetësim.

Mbas takimeve me disa Kryetar të bashkësive lokale, shqetësimi tjetër i tyre është qështja e kanalizimeve, asfaltimi i rrugëve në fshatra, ndriqimi i rrugëve jo funksional etj. Andaj kërkoj një zgjidhje për këto probleme sa më parë.

Kryesuesi Argjend Thaçi: Urdhëro, Nebih Bibaj

Nebih Bibaj (anëtar nga PDK): Dhe ne do të i ngrisim disa qështje të cilat janë në interes të qytetarëve. Sigurisht me Halilin dhe Eqremin ndajm pjesën të cilët ju e rrëfyt këtu në kuvend, kjo na shqetëson të gjithëve. Është mirë me bërë thirrje Kryetari te institucionet e sigurisë që të marrin masa më shumë.

Qështja e dytë e cila dua ta ngris është qështja e mbeturinave, rrugës për Senik është pamja jashtëzakonisht shumë e keqe ka shumë mbeturina, ka shumë mjete të ndërtimit të cilat i hudhin, mirë është me marr shënim dhe me ju dal në ndihmë atyre qytetarëve që kalojnë në atë pjesë. Të paktën këtë pjesën e mbeturinave mundemi me menaxhu më lehtë.

Një qështje tjetër te Drejtoria e Arsimit dua ta ngris. Në fshatin Mleqan drejtori i shkollës në të njëjtën kohë ushtron dhe pozitën e arsimtarit të Gjeografis. A mundet me ndodhë kjo dhe përse është duke ndodhur?

Qështjen tjetër që dua ta ngris ka të bëjë me projektet. Drejtor, kur ka me fillu projekti kryesor i rrethit në Malishevë?

Në cilën fazë jeni me projekte?

A është e mundur që të devijohet dhe ky projekt si te gjimnazi me ju hek nënkalmi, sepse kam dëgjuar që do të largohet nënkalmi në atë pjesë. A do të shkon projekti sipas paramasave siç ka qenë apo ka dhe ndonjë ndryshim të projektit?

Kryesuesi Argjend Thaçi: Urdhëro, Rukije Bytyqi

Rukije Bytyqi (anëtare nga Nisma Socialdemokrate): Meqenëse jemi në prag të festës së 8 Marsit kërkoj nga Kryetari që të nderohen të gjitha ato femra kontributdhënëse ndër vite të cilat kanë dhënë kontribut të madh në fusha të ndryshme si në luftën e fundit të Kosovës, në

shëndetësi si dhe në shumë fusha të tjera. Mundi i tyre ka bërë që femra në Komunën e Malishevës mos me qenë e shtypur mirëpo të jetë ajo që kësaj shoqërie i dhuron çdo ditë e më shumë vlera të mëdha.

Kryesuesi Argjend Thaçi: Urdhëro, Valon Mazreku!

Valon Mazreku (anëtar nga Nisma Socialdemokrate): Unë sikur Halili dhe Eqremi jemi jo të lirë dhe jo të sigurt kur ndodhë atje mund të ndodhë dhe te ne. Ju ftoj që Kryetari përmes mekanizmave të tij ti shfrytëzoj sa ka mundësi, të bashkëbisedoj me organet kompetente që të rritet vigjilenca në raport me këto dukuri të cilat janë duke ndodhë, sepse njeriu duhet të ndihet i lirë dhe i sigurt në shtëpinë e vetë.

Në Komunën e Malishevës janë duke u zhvilluar një mori projektesh gjigante, të cilat jo vetëm që e kënaqin syrin tonë por do të mbesin për një periudhë jashtëzakonisht të gjatë në funksion të qytetarëve të Malishevës. Falenderoj Kryetarin për angazhimin e ti që është duke e bërë bashkarisht me stafin e tij qeverisës, në realizimin e këtyre projekteve ashtu siç ka premtuar gjatë fushatës elektorale, ku mbi bazen e këtyre ka marrë dhe mandatin e Kryetarit, që nuk dyshoj që do ta ketë dhe mandatin tjetër.

Kryetar, e kam një pyetje, tani së fundi komuna ka qenë përfituese e grantit të performancës në një vlerë mbi 600,000.00E, dhe konsideroj që është e dobishme si informacion për qytetarin dhe për ne njëkohësisht të dimë se cilat projekte do të financohen nga ky grant i performancës?

I kam dhe disa pyetje për Drejtorat këtu meqenëse Drejtori i Urbanizmit më ka premtuar që do të largohet, por kur kam kaluar nga lagjia Mirëdita ajo trafo nga trotuari nuk është zhvendosur, kisha kërkuar që ajo të largohet sepse ajo nuk e pengon lëvizjen por e ndalon lëvizjen.

Po ashtu në rrugën Ibrahim Mazreku nga rrethi të ambullanta deri te rrethi i cili është në lagjen e Gurit 7 trupa ndriques nuk kanë ndriqim. Është mirë me pa se cili është defekti aty dhe me rregullu.

Po ashtu dëshirova me ja dhënë një informacion Valon Krasniqit, për punsimet partiake nuk e di tani a po ndodhin punësimet partiake. Deshta mem tregu një punëtor në KEK si e punësoj pasi që jeni e qeveris lartë?

Kryesuesi Argjend Thaçi: Urdhëro, Alban Kastrati!

Alban Kastrati (anëtar nga PDK): Edhe unë solidarizohem me qytetarët të cilëve po ju thyhen shtëpit dhe po vjedhen pasurit e tyre, kërkoj nga organet përgjegjëse të mirren me rastin konkret dhe të ju ofrojnë qytetarëve sa më shumë siguri.

Kryetar, ditëve të fundit janë duke u kryer disa punime nga ana e KEK-ut, ata po vendosin disa shtylla dhe disa ora të rrymës mirëpo dëmet të cilat janë ka i shkaktojnë janë dëme shumë të mëdha. Vetëm në lagjen time dje janë dëmtuar shumë rrugët përveq rrugëve po hyjnë dhe në oborre, po dëmtohen oborret dhe kopshtet. Kisha kërkuar të formohet një Komision monitories, mbikqyrës që të ju bëhet me dije që të kenë kujdes mos të ju dëmtojnë pronat e qytetarëve dhe veqanarisht rrugët e asfaltuara.

Kryetar, jo shumë larg shtëpis ku jetoni ju, në Turjakë, mundem me thënë 500m larg, nuk e di a e keni vërejt ka shpërthyer gypi i ujrave të zeza është dalë në sipërfaqe dhe është një kundërmim

aq i keq dhe mund të sjellë epidemi për qytetarët e fshatit Turjakë dhe fshatit Damanek, sepse livadhet janë në mes të këtyre dy fshatrave. Kisha kërkuar që gjatë vikendit të shkojmë në vendin e ngjarjes dhe ta shohim se në qfarë gjendje është ajo pjesë. Kërkoj ndërhyrje urgjente që të bëhet sanimi i këtyre gypave.

Kërkesa tjetër që ndërlidhet prap me fshatin Turjakë, të mirret masa urgjente të lagjia e madhe, lagjia e Kastratëve dhe Zogaj, që është demulu krejtësisht rruga kryesor që përqon drejt fshatit Panorc, Llapqevë dhe Bubël.

Kryesuesi Argjend Thaçi: Urdhëro, Mirëlinda Gashi!

Mirëlinda Gashi (antare nga PDK): U ngritën shumë qështje nga kolegët të cilat nuk dua të i përsëris. Dua të i'a bëjë një pyetje Drejtorit të Bujqësis. Janë ndar disa mjete bujqësore tani së fundi, nuk e di përse nuk bëhen publike emrat e fermerëve të cilat i marrin ato mjete.

Pyetje tjetër është për Drejtorin e Inspektoriatit, përse nuk dilni asnjëherë në teren me i shiku rrugët të cilat po dëmtohen?

Kërkes tjetër kemi nga qytetarët e fshatrave, që rrugët janë shumë të dëmtuara e dimë që buxheti pjesa më e madhe po shkonë në qendër por është mirë të paktën ato rrugë të cilat kanë nevojë të rregullohen me ndërhy dhe pa qenë në buxhet.

Pastaj u ngrit nga kolegët qështja në fshatin Astrazup, Valoni e ngriti qështjen e ndriqimit është mirë që ndriqimi në fshatra me qenë më i mirë dhe me u mirëmbajtë.

Kryesuesi Argjend Thaçi: Urdhëro, Burim Paqarizil

Burim Paqarizi (anëtar nga PDK): Unë pajtohem me fjalët të cilat i thanë kolegët dhe besoj që qeverisja do të merr masa.

Unë i kam disa pyetje për Drejtorin e Urbanizmit dhe për Drejtorin e Inspektoriatit ku problemet me ndriqim janë jashtëzakonisht keq, duhet urgjentisht të mirreni me këtë qështje, në shumicën e fshatrave ndriqimi publik është jo funksional.

Rrugët lokale janë në gjendje jo të mirë po ashtu dhe rrugët tranzit.

Një pyetje tjetër punimet në qendër e kemi parë që këto ditë është mbyll dhe pjesa përballë

Komunës si do të menaxhohet pjesa lëvizëse e qytetarëve nëse mbyllet dhe pjesa të rrethi?

A janë krijuar rrugë alternative? A është bërë një menaxhim i mirë i kësaj situate? Kur do të na jepni përgjigje si do të realizohet kjo?

Po ashtu është dhe pjesa e investimeve nga kompania e energjisë e kemi parë që në shumicën e fshatrave është duke i kryer disa punime a është duke u mbikqyr a është duke e kthyr siç ka qenë në gjendjen e mëparshme pjesën në të cilën punon.

Kryesuesi Argjend Thaçi: Urdhëro, Veton Zogaj!

Veton Zogaj (anëtar nga VV): Dua të di nga Drejtoria e Urbanizmit në kordinim me shpalljen të cilën e ka bërë Ministria e planifikimit hapsinor për ndërtimin e blloqeve banesore i cili po quhet banim i përballueshëm, a e keni bërë kërkesën dhe a e keni përcaktu lokacionin? Ku jemi me këtë pikë?

Në këto marrëveshje bashkëpunimi ku fillojnë në shkurt deri në fund të muajit mars dëshirova

ta jap si propozim ndërtimin e një rreth rrotullimit te rruga Adem Jasharit në Tërpezë. Kam biseduar dhe me zyrtarë në Ministri por dhe me deputet të LVV-së. Mendoj që Komuna duhet me bërë një kërkesë që me mundësu një qasje në autostradë është shumë e rëndësishme si Komunë, nuk besoj që do të ketë shumë kosto.

Qështja e tretë ne e kemi marrë si asamble komunale nëse nuk besoj ka qenë propozimi i Rukije Bytyqit, që familja të cilët i kanë dy fëmijë në çerdhe me pas për njërin fëmijë lirim ose zbritje 50% ky vendim nuk është duke u zbatuar. Përse nuk është duke u zbatuar ky vendim?

Pyetja tjetër për Drejtorin e Arsimit është të paktën prej dy prindërve kam marrë një mesazh si informim që i është kërkuar fëmijëve të tyre në çerdhen në Malishevë që të paguajn 5-7 euro për rregullimin e hapsires së oborrit për vendosjen e lodrave. Kjo nuk është në rregull nëse është kërkuar një gjë e tillë sepse është përgjegjësi e Drejtoris Komunale dhe e Komunës.

Kryesuesi Argjend Thaçi: Nëse nuk ka për diskutime ftoj Kryetarin e Komunës që të l'u përgjigjet të gjithë pyetjeve të cilat i ngritët ju si anëtar të Kuvendit.

Urdhëro, Kryetar Ekrem Kastrati!

Kryetari Ekrem Kastrati: Ju falenderoj të gjithëve të cilët jemi këtu së bashku për të debatuar dhe është detyr që qeveria Komunale me i marrë të gjitha këto sipas mundësive dhe buxhetit por dhe teknike që me qenë në gjendje për ti plotësuar të gjitha këto. Të gjitha janë në favor të qytetarëve dhe të gjitha janë në favor të jetës më cilësore të gjithë banorëve tanë të Komunës së Malishevës i cili është objektivi i jonë kryesor dhe i juaji. Kemi me bërë përpjekje që të gjitha këto shqetësime kërkesa të evitojmë sa më shpejtë të jetë e mundur.

Mungesa e asambleistave e theksoj dhe Amrushi është një mungesë e juaja te seancat solemne, ngjarja e seancës solemne kërkon që me qenë dhe ju prezent sidomos kur i festojmë festat kombëtare dhe festat që janë të domosdoshme me i trajtu si festa solemne. Prandaj ju kisha lut që të merrni pjesë sepse në fund të fundit i humb karakteri i seancës solemne nëse ju nuk jeni. Hudhja e mbeturinave edhe kjo është një dukuri shumë negative e qytetarëve tanë, sepse na mungon një vetëdijësim për trajtimin e të gjithë këtyre mbeturinave, ende nuk kemi një vetëdije të lartë. Te mbeturinat inerte e kemi pasur një kontrat me një operator ekonomik i cili ka bërë maksimumin e vetë që të i eliminoj por për fat të keq prapë në ato vende ku ne i kemi pastruar dhe i kemi rregullu të gjitha këto prapë qytetarët tanë kanë hudhur mbeturina. Ju kisha lutur që të ndikoni në mjediset e juaja te votuesit e juaj që mos të hudhin mbeturina ku ne shpenzojmë para për të i pastruar ato.

Situata e siguris që u theksu nga ju në fshatin Astrazup por dhe në fshatra të tjera, vërtet kjo është shqetësuese jo vetëm për mua por për të gjithë ne sepse detyra jonë është siguri i jetës dhe pasuris së qytetarëve. Sa herë që kemi pasur takim me subjektet e sigurisë apo me digasteret të cilat janë përgjegjes për sigurin e kemi theksuar që ti zhvillojë hetimet. Mirëpo nganjëher krimi shkon përpara se sa organet e ndjekjes, kjo është evidente jo vetëm në shoqërin tonë por në të gjitha shtetet. Kjo prapë kërkon bashkëpunimin e qytetarëve sepse elementet e siguris lidhet drejtë për drejti me qytetarët. Ju kisha lutur të gjithëve kush keni informacione që e plotësojnë hendekun e mos informimit dhe mos të dhënave ekzakte të organeve të sigurisë të i plotësojnë ato dhe së bashku të i marrin masat dhe fajtorët të gjinden mbrapa grilave. Nëse e ndjeni të nevojshme në mbledhjen e ardhëshme mund ta ftoj komandatin e Policisë tonë që e kemi në Malishevë me qëllim që dhe ai të ju njoftojë më

detaisht rreth këtyre ngjarjeve.

Aplikimi në ministri përkatëse e theksoj asambleistja e LVV-së, po kemi bërë 4 projekte në Ministrin e planifikimit hapsinor dhe infrastrukturës ato janë shtrati i Lumit Mirusha nga ura deri te ura e tranzitit. Pastaj është një urë që e lidh tranzitin e ri edhe për këtë urë e kemi bërë kërkesën. Kemi bërë kërkesën për urën e Gurbardhit që tashmë ju e keni parë që nuk është në gjendje të mir. E kemi bërë dhe një projekt ku nga stadiumi FC Malisheva me ndërlidh me Pallanka. Nga Lindi center ne jemi duke e ndërtu një rrugë deri te stadiumi nga stadiumi me pas mundësi me ndërlidh përmes Pallanka me rrugën që shkon për Gurbardhë, është një nga arteriet kryesore rrugore infrastukture. Këto 4 projekte i kemi dërguar dhe besoj që do të kemi mirëkuptim nga Ministria e planifikimit hapsinor në bashkë financim.

Ekzekutimi i mjeteve për strehimoren, në vitin 2023 nuk kemi paguar për këtë strehimore këtë vit besoj që do të i paguajm.

Objekti i vlerave të luftës, jemi në fazën finale të përmbylljes së këtij objekti besoj që në festat e Marsit eventualisht me 16 Qershor do ta kemi në funksion të plotë.

Politizimi i përpiktë Valon, është bindje e jotja, nuk dua të cekim që janë të politizuara por te gjitha shkollat në Kosovë ndikohen prej politikës. Drejtorat në shkolla e kanë të ndaluar të ushtrojnë aktivitet politik por simpatin për ndonjë subjekt politik nuk mund të ja ndali askujt. Qenët endacak e kemi cekë shumë here, asnjë komunë në mënyr selektive nuk mundet me luftu këtë dukuri, për shembull me bërë një kontrat me operatorin ekonomik dhe i sterilizojmë, i strehojmë të gjithë qenët endacak, por prap ka me u mbush sepse vinë nga komunat e tjera. Duhet Qeveria qendrore me pas një strategji shumë të mirë.

Mbeturinat inerte të fshatit Senik që u cek, vërtet është një pamje shëmtuese besoj që tani në pranverën e hershme do të fillojmë për trajtim të asaj.

Te shkolla e Mleqanit pyetët për Drejtorin por Drejtoresha e Arsimit do të përgjigjet në këtë pyetje sepse nuk jam i informuar rreth kësaj qështje.

Projekti i sheshit Nebih, nuk besoj që ka me pas devijim nga projekti i kontraktum. Pamundësia jonë për mos disponim të pronës publike na ka dhënë dhe imponimin për ta ndryshuar atë projekt.

Festa 8 Marsi, është një ndër festat që e kemi për zemër sepse të gjithë kemi gra, motra dhe sigurisht që kemi dëshirë me festu në mënyrë të dinjitetshme sepse gruaja dhe femra në Malishevë ka nevojë që të trajtohet më mirë për arsye të meritave historike.

Granti i performancës kemi punuar shumë me ekipin e performancës por dhe me digastere të tjera në komunë që na është dashur prej 190 indikatorëve ta masim vetëvetën se ku jemi në raport me komunat e tjera. Kemi arritur që prej 11 komunave të selektohem dhe ne, kemi zënë vendin e 6 apo 7.

Investimet e KEDS-i të cilat është duke i bërë në Komunën e Malishevës, ne kemi pasur takime me Drejtorin e Urbanizmit dhe me përfaqësuesit e KEDS-it dhe ju kemi lutur shumë me investu në Komunën e Malishevës. Ju e dini që nga viti 1978 shumë pak është investu në fshatra te shtyllat elektrike dhe shtyllat të cilat e përquajnë energjin elektrike. Ata na kanë premtuar që do të bëjnë investime dhe janë duke i bërë, mirëpo i kanë dëmtuar disa prona publike dhe private ne do të kërkojmë përmes një komisioni për me i sanu të gjitha ato dëme dhe ta kthejnë në gjendjen e më parshme.

Ujrat e zeza në Turjakë dhe Damanek e kemi bërë një kontrat për këtë projekt, mirëpo ai projekt ka dalë jashtë funksioni dhe ka dalë që ne duhet të shpenzojm më shumë para në këtë drejtim

sepse projekti i më hershëm nuk ka shkuar mirë. Po presim të thahet ajo zonë dhe të punojmë. Rruga për Panorcë, jo vetëm rruga për Panorcë por kemi shumë rrugë të cilat janë shumë të dëmtuara, rrugë të cilat janë të ndërtuara më herët por që tani kushtet e asaj rruge nuk i plotësojnë standartet. Besoj që në disa segmente do të punojmë.

Rrugët e dëmtuara në fshatra kemi kontrata për mirëmbajtje të tyre dhe sigurisht menaxheri i kontratës së bashku me Drejtorin e Urbanizmit do ta kenë parasysh se ku do të shkojnë me interveni.

Ndriqimi publik jo funksional, Komuna e Malishevës prin me ndriqim publik për dallim nga komunat e tjera mirëpo mirëmbajtja po na kushton sepse komuna paguan shumë për shpenzimin e energjis elektrike të ndriqimit publik. Ne jemi në shqyrtim e sipër në ato vendet ku nuk cenohet drejtësia si për shembull në fshatrat që i kemi për rreth aty na duhet ndriqimi i përhershëm ndërsa në zonat e mbrendshme mundemi me bërë me orar. Duhet ta marrim dhe miratimin e juaj që mos me pas ndriqim gjithë natën por vetëm sa kemi njerëz në rrugë.

Bllokimi i rrugëve, ju e dini që tani kemi hyrë në fazën e rëndësishme të implementimit të projektit dhe segmenti kryesor ka me u blloku, besoj që kemi gjetur rrugë alternative me inxhinier dhe jemi duke punuar në atë drejtim.

Fëmijët për qështjen e pagesës në çerdhe po ja lëjmë këtë pyetje të përgjigjet Drejtoresha e Arsimit.

Pastrimi i hapsirave në çerdhe, unë nuk e pëlqej që të kërkohet para nga fëmijët për rregullimin e infrastrukturës për rreth shkollave dhe në shkolla por në rast se ekziston vetë iniciativa e prindërve dhe shkollës unë nuk e ndaloj askënd që shpreh gaditshmëri për të dhënë donacion për rregullimin e klasave apo ndonjë ambient. Në të kundërtën nuk ka imponim apo detyrim që fëmijët tanë me pagu diqka që nuk i përket.

Faleminderit!

Kryesuesi Argjend Thaçi: Vazhdojmë te rendi i ditës, si pikë të re kemi kërkesën e Kryetarit. Urdhëro Nebih Bibaj!

Nebih Bibaj (anëtar nga PDK): Kryesus pasi jemi duke hyrë në rend të ditës ne si grup parlamentar i PDK-së i kemi disa kërkesa të arsyeshme për ekzekutivin në të njëjtën kohë dhe për ju si Kryesus. Ne mendojmë që seanca e sotshme nuk duhet të vazhdojë për këto arsye: Ofrimi i shërbimit të punës në Kuvend për asambleistët, ke asambleist që duhet me u sjellë deri të gjen një ulësë si duhet për tu ulur, mikrofonat, qështja e kamerës mbrapa e cila nuk funksionon, kartelat unë kam një kartel ndërsa të tjerët nuk kanë.

Mendoj që dhe grupet e tjera opozitare duhet me u pajtu me këtë drejtim, totalisht është e injoruar opozita në vendimarrjen e kuvendit. Asnjë vendim i opozitës nuk është shkuar përpara, ka sabotim, ka injorim aq të madh sa që ne nganjëherë pyesim përse vimë në kuvend. Ti Kryetar ke kërku që ky mandat të jetë bashkëpunues dhe me opozitën por nuk ka ndodh deri tani. Kërkesa e tretë është pagesa e gjitha vendimeve të kuvendit që kanë ndodhë qoftë për raste mjeksore, për çdo rast kuvendi ka nxjerrë një vendim për pages që duhet me ndodhë çdo pagesë e vendimeve të kuvendit. Unë mendoj që derisa nuk realizohen këto kërkesa ne si grup parlamentar do ta bllokojmë seancën, sepse nuk kemi dhe arsye të vazhdojmë për seanca të tjera.

Grupi nga PDK, VV, Lista Guxo Valon Krasniqi dhe Adile Hoxha nga LDK dalin para foltores së Kuvendit dhe nuk lejojnë vazhdimin e seancës.

Alban Kastrati (antar nga PDK): Unë mendoj që dhe Kryesusi duhet të na bashkangjitet, sepse përgjegjësi më i madh i kësaj gjendje është Kryesusi i cili asnjëherë deri më tani nuk e ka ushtru detyren dhe përgjesësit të cilat ja përcakton rregullorja dhe ligji në fuqi. Ai thjesht vjen për ta marrë një pagë dhe këtë pozitë të cilën e ka e merr vetëm si privilegj, jo si përgjegjësi. Pa u kriju kushtet në sallë nuk do të lejojmë të vazhdojë seanca më tutje.

Kryesuesi Argjend Thaçi: Ju ftoj që të uleni në vendet e juaja të gjithë anëtarët e Kuvendit. Urdhëro, Valon Mazreku!

Alban Kastrati (anëtar nga PDK): Seanca nuk mundet me vazhdu në këto rrethana. Asnjë kërkesë e jona nuk është përfillë, ju i keni numrat por ne nuk do të lejojmë ashtu.

Kryesuesi Argjend Thaçi: Nuk do të thotë që një kërkesë e mazhorancës është plotësu dhe e juaja jo, problemi nuk është vetëm i opozitës por është i të gjithë anëtarëve të kuvendit.

Alban Kastrati (anëtar nga PDK): Kryesus, mos insisto më shumë sepse vetëm qka e tensionon gjendjen më shumë. Seanca nuk vazhdon ne i kemi kërkesat e tona, kërkesat tona duhet të shqyrtohen dhe duhet të caktohet një afat kur do të plotësohen.

Valon Mazreku (anëtar nga Nisma Socialdemokrate): Në radhë të parë dëshirova të ju përkrahë, sepse nuk është kërkesë e cila po rrjedh sot, funksionalizimi i të gjitha paisjeve të kuvendit të cila ne i kemi për me ushtru aktivitetin tonë është kërkesë që është bërë që një kohë. Është përgjegjësi e Kryesutit dhe Drejtorit të Administratës me u merr me këtë qështje, pa shmangshëm që i takon dhe Kryetarit, sepse është në ombrellën e kësaj Komune. Kisha kërku që me pas mirëkuptim që kjo me qenë mbledhja e fundit që një asambleist mos me pas një karrige me u ul në vendin e vetë.

Kryesuesi Argjend Thaçi: Siç e kam konfirmuar deri më tani kërkesa është dhe mbetet nga ana e ekzekutivit që të përfundoj punën. Urdhëro, Halil Morina!

Halil Morina (anëtar nga Nisma Socialdemokrate): Pa dallim pozitë-opozitë ne i kemi ngre disa shqetësime për mbarëvajtjen e seancës, duke filluar nga kushtet e sallës. Nuk punojnë kamerat, nuk kanë ku të ulen, nganjëherë bëhet nxehtë nganjëherë ftoft.

E kemi diskutu dhe qështjen e pagesave të Komisioneve, të cilën e kam diskutu dhe unë personalisht duhet të zgjidhet kjo qështje nëse është e jashtëligjshme atëherë ta provojmë në gjykatë. E dërgojmë në gjykatë dhe gjykata është ajo që e zgjidhë këtë.

Janë kërkesa të arsyeshme, mirëpo Nebihi e din që ka qenë në mandatin e kaluar, i cili i ka pasur numrat dhe ne nuk i kemi pasur por në asnjë moment nuk kemi përdorur formën për me tentu me blloku seancën. Kemi debatuar, kemi protestuar 2 minuta e kemi shprehur mllëfin tonë dhe kemi ec. Por ky qëndrim i juaji nuk po më duket mënyrë e duhur me zgjidhë këtë problem.

Alban Kastrati (anëtar nga PDK): Unë kisha kërkuar nga të gjithë ju pa dallime një gjë duhet ta kuptoni cili është mandati dhe përgjegjësia juaj si asambleist apo si anëtarë të këtij kuvendi, keni dalë dhe keni kërkuar besimin e qytetarëve dhe jeni zotuar që do të i mbronit interesat e

qytetarëve. Mirëpo mos lejoni që ekzekutivi që nuk ka dalë me kërku besimin e qytetarëve të bëjë hajgare dhe të ju injoroj juve si asambleistë. Mos lejoni një Drejtor të financave ose kush do tjetër me bërë hajgare me ju dhe me ne në përgjithësi. Ju kisha bërë thirrje hajde dhe ju me kërkesat tona dinjitoze dhe reale.

Kryesuesi Argjend Thaçi: Atëherë 16 anëtarë jemi prezent në ulëse.
Urdhëro, Nebih Bibaj!

Nebih Bibaj (anëtar nga PDK): Ne e kemi një veprim politik, veprimi jonë politik është i ligjshëm dhe i arsyeshëm, nuk kemi kërkesa të cilat nuk mund të realizohen. Ti je një Kryesus që ke me udhëheq një seanc, nuk e ke fuqien me udhëheq seancën kur ne jemi para foltorës. Kjo Komunë ka Kryetarin e Komunës i cili duhet me marrë fjalën dhe mu zotu për kërkesat tona të cilat janë të ligjshme. Nëse nuk plotësohen këto kërkesa në seancën tjetër ne dhe mikrofonat i dëmtojm, nuk mundesh me mbajt seanc këtu. Presim Kryetarin të bëjë një zotim para nesh që këto kërkesa kur do të realizohen, caktoje ditën, datën kur do të realizohen këto kërkesa ne tërhiqemi nga vendimi i jonë, përndryshe nuk lejojmë seanc me u mbajtë.

Kryesuesi Argjend Thaçi: Urdhëro, Kryetar Ekrem Kastrati!

Kryetari Ekrem Kastrati: Faleminderit Nebih për sygjerimin, ne kur kemi pasur mundësi i kemi shqyrtu si kërkesa, llaptopat të cilët i keni përpara ju kemi sjellë ne, nuk është që nuk jemi kujdesur ne për ju. Në rast se i shikon llaptopët të cilët i keni kanë kushtuar më shumë se këto qështjet e tjera të cilët janë bërë shkak mos me u vazhdu seanca. Si do që të jetë unë si Kryetar Komune zotohem që në një afatë më të shkurtë të gjitha shpenzimet shkojnë sipas procedurës së prokurorit dhe nuk mundem me caktu një datë, por ju garantoj që procedura do të jetë emergjente.

Kryesuesi Argjend Thaçi: Atëherë meqenëse është ora 12:00 vazhdojmë me pauz dhe rikthehemi prap në ora 13:00. A dëshironi me hudh në votim apo jeni të pajtimit me dalë në pauz?

Valon Mazreku (anëtar nga Nisma Socialdemokrate): Kolegët nga opozita kërkuan zotimin nga Kryetari, dhe Kryetari e dha zotimin e tij që mundet me rregullu këtë qështje. I kërkoj Nebihit me thënë atë që e ceki paraprakisht.

Alban Kastrati (anëtar nga PDK): Kryetari e dha një përgjigjie sipërfaqësore që e ceki që do të bëjë vetëm insitim me rregullu. Ishte dhe një kërkes e Halilit dhe për atë dëshirojmë përgjigjie. Ne jemi për me bërë një kompromis, ne tërhiqemi nëse ju na garantoni që i realizoni këto kërkesa, nuk janë kërkesa marramendëse, janë kërkesa simbolike. Ne vetëm po kërkojmë kushte pune.

Valon Krasniqi (anëtar nga Lista Guxo): Kryetar, sa i përket qështjes sime unë kam dalë në aspektin e opozitës dhe aspektin individual, unë i kam disa parime njerëzore dhe për zotimet e tua dua ti besoj dhe të shikoj se a do të përfundojnë sa më shpejt. Nga ky moment ulem në vendin tim.

Kryetari Ekrem Kastrati: Përmes fjalës ju garantoj që sa më shpejt që është e mundur me i zhvillu procedurat për realizimin e këtyre kërkesave që i keni.

Nebih Bibaj (anëtar nga PDK): Kryetar, i ke vendimet e gatshme vetëm dojn zbatim. Dhe këtë herë ne mbas pauzës kthehemi në Kuvend si anëtarë të Kuvendit, nëse ne e shohim që po i neglizhon po të tregoj që deri në realizimin e kësaj kërkesë seancat nuk do të vazhdojnë.

Kryesuesi Argjend Thaçi: Vazhdojmë me pauz, rikthehemi në ora 13:00.

Kryesuesi Argjend Thaçi: Vazhdojmë me rendin e ditës ku kemi kërkesën 01/239 si pikë të re për rendin e ditës nga Kryetari. Kërkes për shqyrtimin dhe marrjen e vendimit për kërkesën e Drejtoris për urbanizëm për rrënimin e objekteve të qendrës për punë sociale dhe sahat kullës, si dhe muzetut në qytezën e Malishevës. Të nderuar anëtarë të Kuvendit të Komunës së Malishevës duke u bazuar në kërkesën e Drejtorisë për Urbanizëm nr.05/92 datë: 28.02.2024 të njëjtën e parashtroj para jush për marrjen e vendimit për rrënimin e objekteve të qendrës për punë sociale, sahat kullës dhe muzeut. Ju njoftojmë se Komuna i ka marrë të gjitha masat e nevojshme duke vendosur stafin e Drejtoris për Shëndetësi duke përfshirë dhe stafin e qendrës për punë sociale në një objekt tjetër për kryerjen e shërbimeve për qytetarët, njëherit kemi kryer procedurat e tjera ligjore për përcaktimin dhe vlersimin e objektit në aspektin teknik. Tani mbetet në autoritetin tuaj për vendimarrje të mëtejme. Sipas shkresës së Drejtoris objektet e cekura nuk kanë qenë të paisura me leje ndërtimi, nuk kanë dokumentet e kërkuara sipas ligjit. Të bashkangjitur në material të kësaj kërkesë kemi kërkesën e Drejtoris për Urbanizëm së bashku me elaboratin për ekzaminimin e objekteve në fjalë.

Kërkoj që kjo pikë të hyjë si pikë e rendit të ditës.

A ka dikush tjetër për rend të ditës?

Urdhëro, Valon Mazreku!

Valon Mazreku (anëtar nga Nisma Socialdemokrate): Unë kisha propozu që pikat e fundit 4 kërkesat të renditen pas procesvërbalit në rend të ditës.

Kryesuesi Argjend Thaçi: Urdhëro, Amrush Helshani!

Amrush Helshani (anëtar nga Nisma Socialdemokrate): Të nderuar anëtarë të asambles unë dua të propozoj që në rend të ditës të futet zëvendësimi i anëtarës së Komitetit për Komunitete, e cila është angazhuar diku tjetër.

Kryesuesi Argjend Thaçi: E hedhi në votim kush është për miratim që kërkesa e Kryetari nr.01/239 të hyjë si pikë e rendit të ditës?

Për: 15

Kundër: 5

Abstenim: 3

Me 15 vota për, 5-Kundër dhe 3-Abstenime hynë si pikë në rend të ditës.

Kemi propozimin e Valonit që pikat e rendit të ditës numër 7,8,9,10 të vendosen si pika pas procesvërbalit.

Kush është për këtë propozim të Valonit?

Me vota unanime miratohet ky propozim.

Propozimi i Amrush Helshani të futet si pikë e re zëvendësimit i anëtarit të Komitetit për Komunitete. Kush është për këtë propozim që të hyjë si pikë në rend të ditës?
Me vota unanime, hynë si pikë në rend të ditës.

E hedhi në tërësi rendin e ditës me propozime dhe ndryshime të bëra. Kush është për këtë rend të ditës?

Për: 15

Kundër: 5

Abstenim: 3

Me 15 vota për, 5-Kundër, 3-Abstenime miratohet ky rend i ditës.

Rend i ditës:

- 1.Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së parë të rregullt të kuvendit të mbajtur me datën 26.01.2024.
2. Shqyrtimi i kërkesës nr.02/91 datë: 20.02.2024
3. Kërkesa nr. 02/55 datë: 06.02.2024
4. Kërkesa me nr. 02/50 datë: 01.02.2024
5. Kërkesa nr. 02/57 datë: 06.02.2024
6. Kërkesën 01/239 Zëvendësimi i anëtarit për Komitetit për Komunitet.
- 7.Zëvendësimi i anëtarit të Komitetit për Komunitete.
8. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr. 01/459 datë 12.02.2024 për iniciimin e procedurës administrative në lidhje me dhënje në shfrytëzim afatgjatë të pronës publike.
- 9.Shqyrtimi i raportit të të hyrave dhe shpenzimeve për periudhën Janar-Dhjetor 2023.
- 10.Shqyrtimi dhe miratimi i planit të punës së KKS-së për vitin 2024.
- 11.Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/151 datë:12.02.2024, për formimin e komisionit vlerësues , me rastin e dhënies në shfrytëzim të pronës publike.
- 12.Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/188 datë:20.02.2024 për formimin e komisionit të ankesave me rastin e dhënies në shfrytëzim të pronës publike në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë.

Pika e parë

Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së parë të rregullt të kuvendit të mbajtur me datën 26.01.2024.

Kush është për miratimin e procesverbalit të mbledhjes së rregullt të kuvendit të mbajtur me datë 26.01.2024?

Për-20

Kundër- 0

Abstenim-3

Me 20 vota për, 0-Kundër, 3-Abstenime miratohet procesverbali i mbledhjes së parë të rregullt të mbajtur me datë: 26.01.2024.

Pika e dytë

Shqyrtimi i kërkesës nr.02/91 datë: 20.02.2024.

Janë katër kërkesa të natyrës së njëjt për ndihmë me mjete financiare, për trajtim të sëmundjeve shëndetësore. Unë në mbledhjen e kaluar e kam cekë një shumë unike për këto raste. Urdhëro, Halil Morinal

Halil Morina (anëtar nga Nisma Socialdemokrate): Së pari shpresoj që ta tejkalojnë këtë sëmundje dhe të shërohen sa më shpejt këta qytetarë. Dëshira jonë me i ndihmu shumë nuk përputhet me mundësit tona, ne e kemi bërë një standart të mirë që mos me bërë politik dhe mos me bërë si qështje ankandi këtë qështje, kështu që ne jemi të pajtimit me i ndihmu njëjtë të katër kërkesat.

Kryesuesi Argjend Thaçi: Ashtu jemi pajtu në mbledhjen e kaluar që shuma me qenë 1,500E. Urdhëro, Alban Kastrati

Alban Kastrati (anëtar nga PDK): Edhe ne pajtohemi me Halilin. Ne nuk kemi nevojë të shtyhem këtui të dhëjmë propozime të ndryshme. Mirëpo mirë do të ishte me qenë këtu Drejtori Blerim Thaçi, me na dhënë sqarime sa i përket mundësive buxhetore.

Kryesuesi Argjend Thaçi: Atëherë e hedhi në votim miratimi i kërkesës nr. 02/91 datë: 20.02.2024 të i ndahen mjetet financiare në shumën 1,500E për trajtim shëndetësor. Kush është për?

Me vota unanime miratohet kjo kërkesë.

Pika e tretë

Kërkesa nr. 02/55 datë: 06.02.2024. Kush është që të i ndahen mjetet financiare në shumën prej 1,500E për trajtim shëndetësor?

Unanimisht, miratohet kjo kërkesë.

Pika e katërt

Kërkesa me nr. 02/50 datë: 01.02.2024 kush është për ndarjen e mjeteve financiare në shumën prej 1,500E për trajtim shëndetësor?

Unanimisht, miratohet kjo kërkesë.

Pika e pestë

Kërkesa nr. 02/57 datë: 06.02.2024 kush është për ndarjen e mjeteve financiare në shumën prej 1,500E për trajtim shëndetësor?

Unanimisht, miratohet kjo kërkesë.

Pika e gjashtë

Kërkesën 01/239 meqenëse është kërkesë e ardhur përmes Drejtorisë për Urbanizëm a e dëshiron fjalën Drejtor apo Kryetar.

Urdhëro Drejtor, Avdi Morina!

Avdi Morina (Drejtori për Urbanizëm): Siç e dini projekti kryesor sheshi së bashku me nënkalimin tokësor e kemi diskutuar si projekt në hapat e parë të projektimit të këtij projekti me rëndësi. Në kuadër të këtij projekti siç e keni vërejt që disa objekte të cilat janë të ndërtuara në pronat publike, kemi pasur raste kur kemi pasur pengesa dhe nga pronarët të cilët e kanë ozorpuar në një kohë të pacaktuar pronat e Komunës. E dini që hapi parë ka qenë duke filluar nga Bulevardi "Ibrahim Mazreku", lirim i hapsirave publike dhe pastaj deri në zbatimin e

projektit i cili tashmë është pothuajse në fazën përfundimtare po presim që në pranver ta përfundojmë si të tërën. Ne kemi filluar me projektin e dytë që ndërlidhet me sheshin e dëshmorëve me parkingjet nëntoksore, me nënkalimet dhe mbikalimet. Ky projekt i cili pritet të realizohet fillon nga rreth rrotullimi i cili është i propozuar rrugës për Banjë apo ndryshe rruga Skëndërbeu. Në anën e majtë nga rruga "Avdyl Krasniqi" e cila është mbyll përkohësisht e cila është me dy kursi, në anën e majtë kemi disa objekte të cilat po planifikojmë në bashkëpunim me qytetarët të lirohen disa nga pronat publike. Rruga Skëndërbeu me 4 korsi në pjesën e sheshit depërton nivelin minus 6 metra, kuota 572.9 dhe nivelin e rrugës "Ibrahim Mazreku" te rrethi ekzistues ku do ta kemi një nënkalim. Vendkalimet për këmbësor janë sipas standarteve europiane të paraqitura në projekt të cilat mund të kalojnë në anën tjetër dhe gjithashtu në parkingun nëntokësor.

Këmbësorët të cilët vijnë nga drejtimi i rrugës nga stacioni i autobusëve mund të vijnë të pa penguar. Kemi disa prona të ozorpuara te pjesa e barnatoreve por të cilat duhet të lirohen sepse tashmë ne kemi shpallur thirrjen dhe kemi dalë i kemi njoftuar të gjithë pronarët.

Ajo që na mbetet si pjesë kryesore është qështja e sahat kullës së bashku me muzeun sepse hapsira për me ndërlidh rrugën e cila kalon nga ura kryesore për te dalë te rrethi i cili do të ndërtohet nuk ka hapsir të mjaftueshme për korsi të lirë të automjeteve. Prandaj ne si digaster për këtë rast ju kemi drejtuar zyrës së Kryetarit, ky projekt nuk është vetëm i joni por është projekt i përbashkët i juaji, i qytetarëve të Malishevës dhe secili e jep kontributin e vetë që të realizohet siq është më së miri. Kemi bërë dhe një analizë laboratorike dhe në bazë të saj dhe konstruksioni nuk është në nivelin e knaqshëm. Kërkoj nga ju që ky projekt të realizohet ashtu siq është i planifikuar.

Kryesuesi Argjend Thaçi: Urdhëro, Alban Kastrati!

Alban Kastrati (anëtar nga PDK): E ndëgjova me vëmendje Drejtorin, u mundua me tregu gjendjen e objektit muzeut dhe sahat kullës. Më kujtohet kur kam qenë Drejtor i shërbimeve publike kur e kanë ndërtu, Kryesus, ka qenë Ragip Begaj, ka qenë një investim kapital shumë i rëndësishëm për atë periudhë që i ka dhënë një pamje të bukur qytezës së Malishevës. Unë mendoj që është një vlerë e qytetit të Malishevës dhe ja dhuron një pamje shumë të bukur dhe tani vijm në një situat ku duhet ta rrënojmë. Cili është ai investim tjetër që do të ja dhuroj një pamje të bukur se ky muze që e kemi ne tani?

I bie që ne investimet tona, parat e tona, taksat e qytetarëve çdo 10 vite duhet me i rrënu. Mos po e teprojm me keqpërdorim të mjeteve investo, rrëno, prap investo. Nuk më duket që e arsyeton asnjë projekt qfarë do qoftë ai dhe projekti në fjalë që po e quani Malisheva urbane me rrënu një aset, një kapital kaq të rëndësishëm të qytezës së Malishevës. Unë konsideroj që është një hap shumë i gabueshëm dhe kisha kërkuar të mos të rrënohet. Objekti social është në rregull, është objekt i vjetër nuk ka asnjë vlerë, por të rrënohet sahat kulla dhe muzeu, unë konsideroj që nuk e arsyeton dhe nuk e mbulon asnjë formë.

Kryesuesi Argjend Thaçi: Urdhëro, Burim Paqarizil

Burim Paqarizi (anëtar nga PDK): Sot gjatë seancës na ka ardhë një pikë shumë e rëndësishme mbase nuk kemi pasur dhe shumë kohë ta analizojmë si pikë të rendit të ditës, është dashur të na vijë më herët me analizu më mirë dhe me i adresu saktë vërejtjet dhe sygjerimet tona nga këndi jonë i opozitës. Unë mendoj që objekti i muzeut dhe sahatkulla e kanë një vlerë që e kanë

krijë në qytetin e Malishevës mbi një dekad, besoj që objekti në fjalë shumë lehtë kish mundur me u inkurpuru në projektin e Malishevës Urbane i cili është duke u investu projektin i sheshit. Një vlerë mjaftë e madhe e parave publike është shpenzu për tu ndërtuar një objekt i tillë ku është shfrytëzuar si muze dhe bibliotek. Ne jemi tu i keqpërdor 350.000.00E, nuk janë vetëm këto 350,000.00E por janë dhe 350,000.00E të tjera që kanë me u investu për ta ndërtuar një objekt tjetër të ri që i bie afërsisht 1 milion euro jemi duke i keqpërdor. Ju kisha lut të analizohet kjo pjesë që objekti në fjalë mundet me u ridizajnu me u riprojektu por mos të humben mbi 1 milion euro.

Kryesuesi Argjend Thaçi: Urdhëro, Valon Mazrekul

Valon Mazreku (anëtar nga Nisma Socialdemokrate): Kjo pikë e cila vetëm sa u fut në rend të ditës ka lidhshmëri me pikat të cilat janë mbrenda rendit të ditës, me një kuptim i paraprin zhvillimit të procedurave. Me objektet publike administron ekzekutivi, kemi pasur në mandatin e kaluar një shembull ku disa prej deputetëve këtu kanë marrë vendim që me ju nda zyre në objekte të Komunës disa subjekteve politike, kur është shkuar vendimi në MAPL ata kanë thënë që nuk është qështje e Kuvendit është qështje e ekzekutivit si i administron objektet administrative. Avdiu e elaburoj që dy objekte janë penges me zvellu dhe me implementu sheshin ashtu si është në projekt së bashku me parkingun nëntoksor. Konsideroj që në kuadër të ekzekutivit të mirren këto dy vendime për këto dy objektet administrative. Unë i mbështes. Këtu është përgjegjësia më e madhe sepse bëhet fjalë për parat publike dhe duhet me pas një qasje tjetër. Sahat kulla dhe muzeu pajtohem me Burimin kur e ceki që ka qenë një pjesë që është shfrytëzuar nga qytetarët sepse ka qenë muzeu dhe biblioteka që kanë mundur me frekuentu një kategori e njerëzve që kanë pas vullnetin. Mirëpo sa i përket identifikimit si objekt me na identifikim neve si Komunë e Malishevës, kjo nuk ka ekzistuar asnjëherë, as kurr nuk ka me na identifikim, sepse nuk paraqet asnjë vlerë të Malishevës. Ndoshta në kohën kur është ndërtu është konsideru që i plotëson kushtet. Meqenëse ka ardhur kërkesa në Kuvend po kërkohet të mirret vendimi për rrënim unë konsideroj që duhet me u mbështet sepse rritet vlera dhe bëhet implementimi real ashtu si kërkuan kolegët nga PDK që mos të ketë devijime të projektit.

Kryesuesi Argjend Thaçi: Urdhëro, Halil Morina

Halil Morina (anëtar nga Nisma Socialdemokrate): Kjo kërkesë që është ardhë nga Drejtoria e Urbanizmit është rrjedhojë logjike e një vendimi paraprak që e kemi marrë ne kur kemi vendosur me bërë sheshin e Dëshmorëve. Kur ne e kemi votuar pro sheshin e dëshmorëve, ky lokacion dhe këto dy objekte të cilën është ardhë kërkesa për me u rrënu, kjo parcelë ka qenë e integruar në këtë shesh. E kemi parë që do të bëhet rrugë dhe e kemi ditë që do të rrënohen këto patjetër, sepse nuk ka pasur alternativ tjetër. Nëse nuk keni dashur të rrënohen këto dy objekte nuk është dashur me u implementu. Meqë këto dy objekte sidomos po flasim për objektin ku ka qenë administrata për punë sociale ka qenë krejtësisht e demoluar dhe jashtë qdo kriteri me ushtruar një aktivitet të tillë. Në mandatin e kaluar jemi përballë me shumë kërkesa për shkak të mungesës së energjis elektrike në atë objekt, dhe KEDS-i e ka cekë që nuk mundet me shku me instaluar rrymen sepse nuk e kam projektin e atij objekti me tregu nga kanë shkuar telat e rrymës. Jemi përballë me një sërë problematikash në mandatin e kaluar për arsye të këtyre pengesave që nuk ka pasur projekt. Unë mendoj që nuk është keq me prish edhe nëse nuk na kish pengë si projekt ka qenë problem me mbajtje atë objekt që nuk ke plan të saj.

Kryesuesi Argjend Thaçi: Urdhëro replik, Burim Paqarizi!

Burim Paqarizi (anëtar nga PDK): Sa i përket pjesës si objekt tregova në europ objektet çdo herë renovohen, ridestinohen dhe munden me u shfrytëzua nga qytetarët. E ceki Valoni që të gjithë prishin dhe ndërtojnë shtëpi të re, 99% e ndërtojnë shtëpin vetëm kur të ndahen sepse askush nuk e prish shtëpin e re dhe me ndërtu tjetër. Ne kemi qenë në ndëgjim publik dhe e kemi parë mënyrën si është shtru dhe është projektu ajo. Pjesa e sheshit ka qenë blloki A dhe blloki B, unë i kam bërë disa pyetje gjat prezantimit blloku A dhe blloku B kanë qenë opsional që kanë pasë mundësi me u bërë ose mos me u bërë që mos të prishet prishet projekti i sheshit. Për këtë arsye po e ceki që ky objekt mundet me u trajtu dhe mundet me u ridestinu, që mos të shpenzojmë para kotë.

Kryesuesi Argjend Thaçi: Urdhëro replik, Halil Morinal

Halil Morina (anëtar nga Nisma Socialdemokrate): Burim, i kemi dy institucione me vlerë të madhe muzeu dhe biblioteka për këto dya më intereson pasi të rrënohet ky objekt dhe të rregullohet sheshi se ku do të i ndërtojmë këto dya. Duhet të gjindet një vend i përshtatshëm dhe për qytetarin me pas mundësi me pas më afër bibliotekën që me mujt me lexu ndonjë gjë.

Kryesuesi Argjend Thaçi: Urdhëro, Valon Mazrekul

Valon Mazreku (anëtar nga Nisma Socialdemokrate): Burim, ne e cekëm në kontekstin e vlerave trashëgimore qka prezanton, objekti në fjalë nuk prezanton asnjë vlerë, përveq asaj pjesës funksionale që ka funksionu si muze dhe si bibliotekë. Pyetjen që e bëri Halili ka qenë mirë me bërë Burimi ku kanë me u vendos këto dy institucione sesa pjesën emocionale të lidhur me objektin që nuk ngjason me asgjë përveqë një penges për arsye të funksionimit të rrugës që ka me u vendos.

Kryesuesi Argjend Thaçi: Urdhëro, Veton Zogaj!

Veton Zogaj (anëtar nga VV): Pajtohem me Valon Mazrekun, që tha kërkesa e tillë nuk ka pasur nevojë të na vijë në kuvend, sepse kur kanë filluar procedurat me u ndërtu ky objekt nuk është pytur kuvendi dhe realisht ka qenë barrë e ish Kryetarit dhe e Drejtorit së Urbanizmit. Kur ka kërkesa të kësaj natyre që janë shumë të rëndësishme është mirë me i ardhë më herët asambles sepse kemi nevojë me u konsultu me subjektet tona se qfarë qëndrimi me mbajtë për një pikë të rendit të ditës. Shpresoj të përmissohet administrata e kuvendit dhe në mbledhjet e tjera të na i sjellni me kohë dokumentet për këto pika të rëndësishme.

Ndoshta jemi subjekti më i zëshëm që e kemi kriju shpeshëherë objektin, mënyrën siq është ndërtu, procedurat që sjanë përfillë. Unë e ndaj një lloj përvoje personale me ish drejtorin e administratës z.Mazreku, kur e kemi marrë zyrën në sahat kullë nuk kemi mundur kurr me funksionalizu si zyre për arsye sepse nuk ka pasur mundësi me u kyq njëhësorët elektrik, instalimet e ujit dhe të gjitha tjerat.

Unë kam një pyetje për drejtorin Avdi. A e keni liru hapsiren publike rreth këti objekti nëse ka ozurpim të pronës publike nga përsoneat privat aty së pari fillon me këta, sepse në fund të fundi : kjo është pronë e Komunës e rrënon qysh të i konvenon në rrethana të ndryshme.

Kryesuesi Argjend Thaçi: Së pari po i përgjigjem Vetonit lidhur me kritiken që i dha administratës së kuvendit ne nuk mundemi me sjellë një dokument kur nuk është ardhë ende te ne. Kjo është ardhë sot dhe ju kemi sjellë, Kryetari ka të drejtë me sjellë kërkesa në ditën kur mbahet seanca. Urdhëro, Drejtor Avdi Morina!

Avdi Morina (Drejtor për Urbanizëm): Së pari nuk do të keqpërdoret emri i Muzeut, sepse nuk do të i ndryshohet, kudo që vendoset muzeu do ta mbajë emrin e dëshmorit që e mbanë tani "Jahir Mazreku".

Drejtorja për gjeodezi dhe kadastër ka muaj të tërë që i ka përfunduar njoftimet me kohë për të gjithë ozorparatorët të cilët e kanë ozurpu pronën publike. Lirimi i hapsirave publike prej ish urës e tutje ju e dini që është liru, njëkohësisht prej të hënës do të fillojmë me pjesën tjetër prej urës deri te rrethi rrugës për Libizhdë dhe rrugës për Banjë dhe të gjitha pronat të cilat janë të ozorpuara normalisht që do të fillojë lirimi. Ne kemi dalë në bashkëpunim me Policinë e stacionit të Malishevës të cilët i falenderojmë për mbështetjen të cilën e kanë dhënë gjatë gjithë këtij procesi, ju kemi dhënë afatin e fundit që deri të hënën kush dëshiron me bërë lirim të hapsirave publike që mos të shkaktojme më shumë dëme filloni nëse jo të hënën fillon aksioni.

Kryesuesi Argjend Thaçi: Urdhëro, Hamit Lima!

Hamit Lima (anëtar nga LDK): Po ndërlidhem së pari te sahat kulla kur është ndërtu kanë qarkullu zëra që kanë blerë personat lokale dhe që kanë me ju konpenzu ato lokale. A është e vërtetë kjo a ka persona që kanë blerë lokale dhe a do të ju konpenzohen ato para që i kanë shpenzu në atë objekt?

Këto objektet që janë për rreth a mundeni me na tregu cilat parcela janë publike?

Duam të dimë dhe ne si asambleista a po rrënohen në mënyr selektive siç ka ndodhë lartë apo do të rrënohen ashtu siç e kemi votuar.

Kryesuesi Argjend Thaçi: Urdhëro, Driton Kastrati!

Driton Kastrati (anëtar nga LDK): Në lidhje me rrënimin e objektit të sahat kullës dhe të muzeut nuk duhet me u nxitu, ne sot e shikojmë për herë të parë, realisht disa nuk e kanë dhe nuk jemi të informuar. Drejtori i Urbanizmit e ceki që është bërë një ekspertizë nga dikush që nuk i plotëson kriteret e forcës, duhet me na prezantuar atë dokument nëse ka ashi elemente. E ceki Hamiti, unë e di që një person e ka marrë në shfrytëzim katin sipër e njoh personalisht dhe e di që e ka blerë atë kat, nuk e di a e ka blerë me afatë të caktuar apo si e ka blerë nuk e di, mirëpo a janë shterrë diskutimet, a janë bërë të gjitha hapat e nevojshëm. A duhet patjetër me rrënu? Mos ta bëjmë gabimin me rrënu pa e bërë një analizë. Kur është prezantuar projekti nga personi përgjegjës i kompanisë që e ka hartuar projektin për Malishevën urbane ka thënë që objekti i sahat kullës mund të mbetet siç është por mund dhe të rrënohet nëse ju si Komuna e vlerësoni. Ka thënë që nuk është pengesë me realizu projektin mirëpo le të mbetet ju me vendos. E ka dhënë dhe një opsion ndonjë adaptim të mundshëm të objektit duke e inkorporu dhe objektin ekzistues me objektin që do të ndërtohet për drejtorin për punë sociale dhe institucioneve të tjera Komunale. Nuk e ka cekë asnjëherë që ky objekt e pengon rrugën. Mendimi imë është që duhet me pas kujdes në këto tema kaq të ndjeshme me i trajtu në mënyrë më graduale, më profesionale dhe më me kujdes.

Kryesuesi Argjend Thaçi: Urdhëro Drejtor!

Avdi Morina (Drejtor për Urbanizëm): Deshirova të i përgjigjem Hamitit për parcelat, e ceka që lirimi i hapsirave do të vazhdojë në secilën pjesë të Komunës së Malishevës mirëpo jemi në një pjesë të fazës së implementimit të projektit pikërisht në zonën ku po flisni ju, dhe parcelat që janë publike janë parcela me numër 723004700894-25 dhe parcela me numër 7231004700894-26 këto dya janë parcela publike. Njëkohësisht do të lirohen të gjitha parcelat publike që janë në këtë pjesë. të gjithëve ja kemi rrënuar lokalet që kanë qenë në prona publike, ja ku është dhe Valoni që ja kemi rrënu lokalit e tij nuk kemi bërë tolerime të asnjëri.

Kryesuesi Argjend Thaçi: Urdhëro, Valon Mazreku!

Valon Mazreku (anëtar nga Nisma Social demokrate): Shumë po e cekni ja kemi rrënuar Valonit lokalit, objekti i Valonit nuk ka qenë i gjithi në pronë publike ka qenë një metër por e kemi rrënuar komplet dhe kemi ndërtuar objekt të ri. Është mirë me specifikun një pjesë e saj ka qenë në pronë publike kurse pjesa e tjetër ka qenë me leje ndërtimore të marrur në vitin 1984, sa për informacion sepse munden me mendu që e kam pasur të komplet objektin në pronë publike.

Kryesuesi Argjend Thaçi: Urdhëro, Bashkim Krasniqi!

Bashkim Krasniqi (Drejtor për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë): Unë nuk e shoh të arsyeshme që ne me i diskutu qështjet me emra, nuk është qështje e trajtimit të një asambleisti që me trajtu këtë, janë procedura që janë zhvillu administrative, janë vendime që janë marrë janë ankesa, janë vendimet gjyqësore të gjitha këto janë duke u trajtu dhe në fund ndoshta fiton pala private, ndoshta e fiton Komuna rastin. Aty ku ka pasur pengesa që ka shkuar qështja në gjykat normal procesi gjyqësor është më i madh se vendimi administrativ duhet të presim deri sa të zgjidhet rasti.

Sa i përket qështjes së lokaleve dhe interesave që ka dikush në objektin e sahat kullës do të merremi me ato palë dhe ato palë do të trajtohen me kompenzim apo dëmshpërblim.

Veton Zogaj (anëtar nga VV): Kush do që ka blerë objekt, dhe objekti nuk ka leje ndërtimi Komuna nuk ka asnjë obligim ndaj ti. Përse e ke blerë ti, ku i ke pasur letrat?

Nëse dëshiron me blerë një pronë publike, qoftë banesë apo qfarë të dojë i këkon pronarit të ati objekti lejen e ndërtimit të ati objekti. Nëse nuk ka ndonjë dokument që është legalizuar si objekt atëherë tërhiq mos e blej.

Kryesuesi Argjend Thaçi: Nëse nuk ka dikush për diskutim e hedhim në votim kërkesën nr. 01/239, kush është për?

Për: 15

Kundër: 6

Abstenim: 2

Me 15 vota për, 6-kundër, 2-abstenime kalon kjo pikë e rendit të ditës.

Pika e shtatë

Zëvendësimi i anëtarit për Komitetin për Komunitet. Urdhëro, Arlind Morina!

Arlind Morina (anëtar nga LDK): Ne kemi një propozim që Qëndresa Bytyqi të zëvendësohet me Sakipe Kryeziu.

Kryesuesi Argjend Thaçi: Kush është për këtë propozim me ngritje dore ju lutem?

Për: 14

Kundër: 0

Abstenim: 7

Me 14 vota për, 0-kundër, 7-abstenime miratohet kjo pikë e rendit të ditës.

Pika e tetë

Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr. 01/459 datë 12.02.2024 për iniciimin e procedurës administrative në lidhje me dhënje në shfrytëzim afatgjatë të pronës publike.

E kemi Kryetarin këtu për ta dhënë arsyeshmërin e kësaj pike. Urdhëro, Kryetari

Kryetari- Ekrem Kastrati: Ju falenderoj që po bëheni pjesë e këtij ndryshimi që Malisheva me marrë një kahje tjetër zhvillimore dhe mos me mbet në objektet të cilat ta kujtojnë kohën e mesjetës pa asnjë kuptim, asnjë emocion dhe pa asnjë përmbajtje kulturore, historike, trashëgimore.

Tani e kemi kërkesën e dytë e cila ka të bëjë me dhënien në shfrytëzim të disa pronave të cilat janë boshti apo pjesa determinuese e zhvillimit të Malishevës urbane, sepse përmes këtij vendimi që merret sot Malisheva merr një kahje tjetër të zhvillimit ekonomik dhe infrastrukturor. Ju e dini që buxheti komunës së Malishevës është si është dhe sa po mundemi me i pkitësu nevojat tona për ndërtimin e infrastrukturës si tokësore dhe nëntokësore si të përgjithshme, prandaj është shumë e domosdoshme që ta inkurporojmë dhe kapitalin privat në këtë që ta nxisim zhvillimin ekonomik të Komunës tonë më shpejtë. Kërkojmë mirëkuptimin e juaj që ne së bashku ta ndryshojmë Malishevën pa dallim partit politike. Faleminderit për vëmendje dhe besoj që në fund do ta kem besimin e juaj që Malishevën ta rendisim në qytetet më të mira të Kosovës dhe të rajonit.

Kryesuesi Argjend Thaçi: Urdhëro, Halil Morina!

Halil Morina (anëtar nga Nisma Socialdemokrate): Komuna jonë ka një mori asetesh dhe prona në pronësi të saj, këto prona duhet të i menaxhojmë në mënyrën më të mirë, dhe është detyrë e jona me ruajt këtë pronë, përmes ideve të ndryshme me ja rritë vlerën kësaj prone në mënyrë që të zhvillojmë ekonomisht Komunën tonë. Këtu është interesi i përgjithshëm qytetar dhe interesi i jonë si Komunë. Kjo kërkesë që është ardhë nga Kryetari konsideroj që shkonë në shërbim jo vetëm të ruajtjes por dhe të rritjes së vlerës së pronës të Komunës së Malishevës. Ne jemi dëshmitar të një aseti pishina e Banjës, që sa kohë ne e kemi dhënë në shfrytëzim, një vit-dy e kemi menaxhuar në mënyrë afat shkurtë, qdo ditë po shkonë duke u demolu, përse mos me gjetë ne një zgjidhje si me ja rrit vlerën asaj prone, si me fitu qoftë ne si Komunë por dhe qytetarët e Komunës së Malishevës. Ne kemi filluar me dy projekte dhe këto dy projekte determinojnë dhe pjesë të tjera me u integru në këtë Malishevën urbane. Ne mundemi me integru vetëm duke e ftuar sektorin privat dhe duke u përpjek me i dhënë zgjidhje kësaj pune. Kjo është një ide shumë e mirë e rritjes së vlerës së pronës të Malishevës dhe zhvillimit ekonomik të Komunës së Malishevës. Kërkoj nga ju si anëtar të kuvendit që të ja dhëjmë përkrahjen kësaj pune dhe pastaj të gjithë e dimë si shkojnë procedurat me afatë të gjatë, prap në fund do të vij te ne me u votu a me u dhënë apo jo.

Kryesuesi Argjend Thaçi: A ka dikush për diskutim?

Atëherë e hedhi në votim kërkesën nr. 01/459 datë: 12.02.2024 kush është për?

Për: 15

Kundër: 7

Abstenim: 0

Me 15 vota për, 7-kundër, 0-abstenim miratohet kjo pikë e rendit të ditës.

Pika e nëntë

Shqyrtimi i raportit të të hyrave dhe shpenzimeve për periudhën Janar-Dhjetor 2023.

Urdhëro, Valon Mazrekul

Valon Mazreku (anëtar nga Nisma Social demokrate): Në munges të Drejtorit të financave kisha kërkuar që kjo pikë të shtyhet për mbledhjen e ardhshme.

Kryesuesi Argjend Thaçi: Kush është për që kjo pikë të shtyhet për mbledhjen e ardhëshme? Unanimisht për kjo pikë shtyhet.

Pika e dhjetë

Shqyrtimi dhe miratimi i planit të punës së KKS-së për vitin 2024.

E ftoj kordinatorin Halil Mazreku që ta prezantoj në pika të shkurta.

Halil Mazreku: Sot do ta prezantoj më shkurt pasi që ky plan ka kaluar në të gjitha procedurat e parapara ligjore. Në takimin e parë të KKS-së të mbajtur me datë: 08/02/2024 projekt propozimi i planit të veprimit të punës së KKS-së për vitin 2024 është shqyrtuar dhe rekomanduar për Kuvendin e Komunës, plan ky në të cilin parasheh prioritetet e këshillit për vitin 2024 si dhe na jep një përmbledhje të aktiviteteve të planifikuara për realizimin e synimeve të përcaktuara për këtë vitë. Po ashtu i njëjti përcakton dhe treguesit e matshëm dhe afatet kohore për kryerjen e secilit aktivitet dhe objektivave të parapara.

Ky plan i punës për vitin 2024 është i mbështetur në nenin 6 dhe 9 të udhëzimit administrativ, strategjis nacionale për sigurinë në bashkësi, dhe udhëzuesin për hartimin e planit të punës. Ky plan do të na shërbej si bazë për funksionimin dhe organizimi e aktiviteteve të KKS-së për vitin 2024. Ky plan ka për qëllim që ti bashkërendoj dhe ti kordinoj të gjitha aktivitetet e punës së anëtarëve të këshillit për arritjen e objektivave, ngritjen e sigurisë së përgjithshme të të gjitha komuniteteve. Ju ftoj që ta miratoni.

Kryesuesi Argjend Thaçi: A ka dikush diskutim për këtë pikë të rendit të ditës?

Urdhëro, Rukije Bytyqi!

Rukije Bytyqi (anëtare nga Nisma Socialdemokrate): A do të mbani mbledhje me kryetarët e këshillave të fshatrave sepse ata i japin informatat parësore në bazë kërkesave të qytetarëve për siguri për të gjitha këto qështje.

Kryesuesi Argjend Thaçi: Urdhëro, Halil Morina!

Halil Morina (anëtar nga Nisma Socialdemokrate): Kisha dashur të ngrehi një shqetësim në lidhje me plaqkitjet të shtëpive që po ndodhin në Komunën e Malishevës. Unë e ngrita këtë qështje saktësisht për fshatin Astrazup, ku mbrenda një viti 6-7 shtëpi janë thyer, kjo qështje është qështje e sigurisë. Meqë mbrenda këti këshilli të juaj është dhe policia, kisha kërkuar nga

ju me marrë këtë qështje me më shumë seriozitet. Me i zbulu personat në bazë të kamerave të sigurisë dhe elementeve të tjera.

Kryesuesi Argjend Thaçi: Urdhëro, Alban Kastrati!

Alban Kastrati (anëtar nga PDK): Prej të kaluares si këshillë, a keni nxerr statistika për rastet që po ndodhin në fjalë siç e cekim dhe profa në fjalë. A është numri në rritje dhe cilat janë masat që i keni ndërmarr ose a e keni bërë ndonjë planifikim si me i parandalu këto, sigurisht në bashkëpunim me organet kompetente.

Kryesuesi Argjend Thaçi: Urdhëro, Veton Zogaj!

Veton Zogaj (anëtar nga VV): Si Malishevë në vitin 2023 kemi humbur shumë qytetarë në ndeshje të komunikacionit, unë kisha kërkuar nga ju si anëtarë i këshillit me kërku direkt nga Komandanti i Policisë që patrullat policore me qenë dhe në zonat rurale në fshatra, sepse i kanë disa pika të përgjithshme ku secili shofer i dinë se ku janë qoftë me radar, qoftë si patroll dhe qatë i respekton ligjet por mbas andej po ka raste që po ndodhin me fatalitet.

Kryesuesi Argjend Thaçi: Urdhëro, Halit Mazreku!

Halit Mazreku: Sa i përket takimit me këshillat e fshatrave ne nuk e kemi në plan, por e kemi me Policin e Kosovës konform ligjit për Policin e Kosovës, që i themelon këshillat lokal për sigurinë publike.

Sa i përket vjedhjeve është trajtuar kjo qështje, kjo është qështje më shumë e Komandantit të Policisë, nëse nuk dalin këto statistika në publik nuk mundemi me ndërhy në hetuesi pa përfunduar të gjitha. Shqetësim tjetër është sepse punën organet e hetuesis dhe Policisë e bëjnë me rregull por kur kalon lënda në gjykat te denimet nuk janë në përporcion ose janë shumë të ulëta ato denime, gjë që ju mundëson kryersve të veprave penale me bërë të njëjtën gjë prap.

Patrullimi i Policisë, i kemi rekomanduar disa herë në takimin e këshillit të sigurisë.

Kryesuesi Argjend Thaçi: E hedhim në votim planin e punës të KKS-së për vitin 2024, kush është për?

Me vota unanime, votohet plan i punës së KKS-së.

Pika e njëmbëdhjetë

Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/151, datë: 12.02.2024, për formimin e Komisionit vlerësues me rastin e dhënies në shfrytëzim të pronës publike përmes hedhjes së interesit publik. Bazuar në ligjin për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës të ligjit nr.06/L-092 datë 07.03.2019, neni 17 propozoj formimin e Komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim afat gjatë të pronës publike përmes shprehjes së interesit publik. Formimi i këtij Komisioni vlerësues përbëhet prej 5 anëtarëve, ku 2 anëtarë i propozon Kryetari i Komunës, dy anëtarë Kuvendi dhe një anëtarë nga sektori jo qeveritar. Urdhëro, Valon Mazreku!

Valon Mazreku (anëtar nga Nisma Socialdemokrate): Duke pasur parasysh që dhe herave të kaluara Halili ka qenë më i angazhuar në këtë aspekt dhe përvojën që e ka si anëtarë i kuvendit, konsideroj që është ideal për me qenë pjesë e këtij Komisioni për dhënie në shfrytëzim të pronës publike. Propozoj që pjesë e këtij Komisioni të jetë Halil Morina.

Kryesuesi Argjend Thaçi: Urdhëro, Burim Paqarizi!

Burim Paqarizi (anëtar nga PDK): Unë po e propozoj Alban Kastratin, pasi që në shumicën e komisioneve kanë qenë së bashku dhe besoj që kishin mundur me bërë një punë të mirë.

Kryesuesi Argjend Thaçi: Urdhëro, Donjeta Shijaku!

Donjetë Shijaku (anëtare nga AAK): Unë po e propozoj kolegun tim, Eqrem Morina.

Kryesuesi Argjend Thaçi: I hedhi në votim propozimet. Propozimi i parë ishte Halil Morina. Kush është për që Halil Morina të jetë anëtarë i komisionit?

Me vota unanime bëhet anëtar i komisionit.

Kush është për që Alban Kastrati me qenë anëtarë e komisionit?

Për: 6

Kundër: 10

Abstenim: 1

Me 6 vota Për, 10-Kundër, 1- Abstenim nuk kalon propozimi që Alban Kastrati të jetë anëtarë i Komisionit.

Kush është për që Eqrem Morina të jetë anëtarë i Komisionit?

Për: 14

Kundër: 5

Abstenim: 3

Me 14 vota Për, 5- Kundër, 3- Abstenime Eqrem Morina bëhet anëtarë i Komisionit pas miratimit të listës së përgjithshme.

I shtojmë dhe emrat nga zyra e Kryetarit dhe nga sektori jo qeveritar, lista e emrave në tërësi: Halil Morina, Eqrem Morina, Muharrem Morina, Fitim Shala, Ardian Mazreku. Kush është për këtë listë të emrave?

Për: 13

Kundër: 5

Abstenim: 0

Me 13 vota Për, 5-Kundër, 0- Abstenim miratohet kërkesa nr.01/ 151 me emra të propozuara.

Pika e dymbëdhjet

Kërkesa nr.01/188 datë: 20.02.2024 për formimin e komisionit të ankesave me rastin e dhënies në shfrytëzim të pronës publike në shfrytëzim afatë shkurtër dhe afatë gjatë në Komunën e Malishevës. Në këtë rast formimi i komisionit përbëhet prej 5 anëtarëve, dy anëtarë i propozon Kryetari i Komunës, dy Kuvendi dhe një anëtarë propozohet nga sektori jo qeveritar. Urdhëro, Amrush Helshani!

Amrush Helshani (anëtar nga Nisma Socialdemokrate): Në emër të grupit NISMA propozoj Astrit Sertollin.

Kryesuesi Argjend Thaçi: Urdhëro, Arlind Morina!

Arlind Morina (anëtar nga LDK): Ne e propozojmë Zamira Morina.

Kryesuesi Argjend Thaçi: A ka propozime të tjera?

Nëse nuk ka i lexojë emrat në tërësi nga Zyra e Kryetarit dhe nga sektori jo qeveritare: Valmir Gashi, Fadil Shala, Mërgim Krasniqi, Astrit Sertolli, Zamira Morina. Kush është për këtë listë të emrave?

Për: 14

Kundër: 5

Abstenim: 2

Me 14- vota Për, 5- Kundër, 2- Abstenime miratohet kjo listë e emrave të propozuar.


A e dëshironi fjalën tek pika të ndryshme?

Nëse nuk ka, mbledhja përfundoi ju falenderojë për pjesëmarrje.

Përfundoi në ora:15:00.

Procesmbajtësja:

Argenitë Krasniqi



Kryesuesi i Kuvendit

Argjend Thaçi

